

VENDIM
Nr. 44, datë 25.1.2017

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 250, DATË 24.4.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, 10, 12 e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 250, datë 24.4.2003, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, përmasat e pronës me emërtimin "Garda e Republikës, Njësia Speciale, Pallati i Brigadave" zëvendësohen me përmasat e pronës me numër rendor 6 (gjashtë), sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;

b) Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore hiqet prona me emërtimin "Garda e Republikës, DRPLSH, Ish-Komanda", me numër rendor 12 (dymbëdhjetë), sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi.

Lista përbëhet, gjithsej, nga 2 (dy) fletë dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Garda e Republikës dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

(Të tipit të pronave që inventarizohen si klasa të veçanta)

Institucioni i Pushtetit Vendor

MPB (Garda e Republikës)

Bashkia Tiranë

Fusha e përdorimit të pronës

Ruajtje e Personaliteteve Shtetërore dhe ORV

NR	A			B			C			
	Zona Kadast indeksi hartës	Nr. Pasurive	Emërtesa e pronës Vendodhja	Komponenti Përbërës të Pronës	Sipërfaqja totale e pronës m ²	Nga sip. totale sa ndërtesa m ²	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/Enti përdorues statusi juridik i pronës	Të dhëna të tjera shënime të veçanta
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
			Garda e Republikës							
6	8280		Njësia Speciale		6358.978	1367.4				Ndryshim në metra
			Pallati Brigadave							
				S. 1 Godin		1290.8	Zyra, palestër, sall	MPB	Garda e Republikës	Dy kate tullë
				S. 2 Godin		76.6	Truprore	MPB	Garda e Republikës	Një kat tullë
	Shënim		Trull Funksional		4991.578					
			Sip. Ndërtimore			1367.4				

1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

(Të tipit të pronave që inventarizohen si klasa të veçanta)

Institucioni i Pushtetit Qendror

MPB (Garda e Republikës)

Bashkia Tiranë

Fusha e përdorimit të pronës

Ruajtje e Personaliteteve Shtetërore dhe ORV

Nr	A			B			C			
	Zona Kadast indeksi hartes	Nr Pasurisë	Emertesa e pronës Vendodhja	Komponentet Perberse te Prones	Siperfaqja Totale e Prones m ²	Nga Sip Totale sa Ndertesa m ²	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni/Enti me pergjegjesi administrative	Institucion/enti perdorues statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjere/ shenime te vecanta
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
			Garda e Republikes							
12	8270		DRPLSH		280	240				ndryshim në metra
			Ish. Komanda	S.1. Godin.		240	Garazhe	MPB	Garda republikes	1 Kat tull
	Shënim		Trull Funkcional		40					
			Sip Ndertimore			240				

